



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	28.12.2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSTK	6374	2021	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.943/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 18.11.2021 të parashtruar nga ankuesi **përmes postës elektronike E-maili:ferat.bytyqi@rks-gov.net**, me numër A.nr.943/2021, me adresën: Rr."Vushtrisë", Nr.35 në Prishtinë, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "**masë disiplinore-vërejtje me shkrim**", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa numër A.nr.943/2021 e datës 18.11.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II.MBETET në fuqi** Vendimi me numër protokoli 3512 i datës 20.10.2021 i nxjerrë nga zv. Drejtoresha e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë.

A r s y e t i m

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në vendin e punës "Udhëheqës i Zyrës së Pranimit Lirimit", në Qendrën Paraburgimit në Prishtinë, me datë 20.10.2021 zëvendës Drejtoresha e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë i ka shqiptuar "**vërejtje me shkrim**", sipas Vendimit nr. protokoli 3512, me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të detyrave të punës dhe përgjegjësive të tij, lidhur me lejin e telefonit për një të paraburgosur pa leje nga ana e Gjykatës kompetente, sipas kërkesave paraprake nga ana e të paraburgosurit. Ankuesi vendimin e ka pranuar me datë 20.10.2021.

Kundër Vendimit me nr. protokoli 3512 të datës 20.10.2021, ankuesi ka parashtrua ankesë me datë 18.11.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e regjistruar me numër A.nr.943/2021, përmes postës elektronike ferat.bytyqi@rks-gov.net, me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar pa vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke propozuar që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 20.10.2021.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 24.11.2021 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës-Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë. Me datë 02.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës-Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/17 faqe.

Kolegji administroj këto prova: Ankesën Anr.943/2021 me numër protokolli 5518/2021 të datës 18.11.2021, (E-mail). e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit nr. protokolli 3512 të datë 20.10.2021 i zv. Drejtoreshës Qendrën Paraburgimit në Prishtinë; Shkresë e datës 26.10.2021 E-mail; E-mail i datës 29.10.2021 ora 15:20; E-mail i datës 26.10.2021 ora 5:25; Përgjigje nr. Protokolli 5776/2021 në ankesë e datës 02.12.2021; Kontratën e punës të datës 01.07.2020;Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë viti 2020;Përshkrim i detyrave të punës nr. protokolli 3415 Udhëheqës i pavianit i datës 11.10.2021; Deklaratë e datës 18.10.2021; Deklaratë e datës 13.10.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 29.10.2021 ora 9:39; Njoftim i datë 30.11.2021(E-mail ora 1:52pm).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil bazuar në dispozitën ligjore të nenit 4 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. ku përcakton se: **“nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”**, ku marrëdhënia e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore **vërejtje me shkrim** sipas Vendimit nr. protokolli 3512 të datë 20.10.2021 i zëvendës Drejtoreshës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, është shqiptuar pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, lidhur me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave dhe përgjegjësive të punës, duke i lejuar telefonin një të paraburgosuri, pa leje nga ana e Gjykatës kompetente, sipas kërkesave të tij të datës 08.10.2021 dhe të datës 22.10.2021, si dhe pa aprovimin nga personi përgjegjës të institucion në fjalë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme sepse masa e shqiptuar **“vërejtje me shkrim”**, sipas Vendimit nr. protokolli 3512 të datës 20.10.2021 i lëshuar nga zëvendës Drejtoresha e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, e cila është mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankuesit, është nxjerrë në pajtim me nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, që përcakton se: **“1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi nr. Protokolli 3512 i datës 20.10.2021 i zëvendës Drejtoreshës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, është nxjerrë pasi që mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit, me datë 12.10.2021 ka shikuar kamerat në institucion dhe ka marrë deklarata me shkrim nga zyrtarët, lidhur me rastin e personit që gjendet në paraburgim që të flas me telefon, është marrë për bazë deklarata e datës 18.10.2021 e ankuesit, i cili deklaroi se: **“...kamë dhënë leje për të paraburgosurin që të flasë në telefon me avokatin e tij, pasi jamë pyetur nga oficer i pavijonit** kurse deklarata e të paraburgosurit e datës 13.10.2021 është: **“...kamë folur me telefon me bashkëshorten time oficeri i krahut më ka lejuar të flas me telefon...”**, që në rastin konkret është vërtetuar se ankuesi i ka dhënë leje të paraburgosurit përmes oficerit të pavijonit që të flas me telefon me bashkëshorten e tij, pa pranuar leje nga ana e Gjykatës kompetente, duke vepruar në kundërshtim me kompetencën e tij të përcaktuara në përshkrimin e detyrave kryesore të punës, me nr. protokolli 3415 të datës 11.10.2021 si në vijim: **1.Merret me menaxhimin dhe koordinim e të gjitha çështjeve specifike të personelit dhe të burgosurve (regjimet, kërkesat dhe ankesat pushimet), 2.Si anëtar i ekipit udhëheqës, të jetë i pranishëm në mbledhjet , t'i informoj udhëheqësit për zhvillimin e punëve, 3. Siguron draft raporte dhe kërkesa ditore, javore dhe mujore për Drejtorin e Institucionit, 4. Kryen takime të rregullta me personelin e Pavijonit, 5.Udhëheqësi i Pavijoni duhet të sigurohet se të gjitha**



procedurat janë në pajtim me sistemin legjislativ, 6.Vrifikon standardet e burgut përfshirë edhe sigurimin dhe i raporton Drejtorit,7. Viziton rregullisht të gjithë zonat dhe hapësirat e pavijonit, 8.Nënmbikqyrje të drejtorit udhëheqë ekipin për projekte apo punon në grupe punuese sipas nevojës si(incidentit, hetimit, komisionet), 9. Monitoron dhe vlerëson parimet (rregullat)dhe procedurat si dhe praktikat në ambienti të sigurte të personelit, të burgosurit dhe publikun, 10.Mbikqyrja e mbajtjes së evidencave dhe statistikave të burgosurve në pavijon, 11.Përgaditja e raporteve javore, mujore dhe javore, 12.Rregullisht i raporton Drejtorit mbi mbarëvajtjen e punëve në pavijon, si dhe duke rënë ndesh dhe me dispozitën ligjore të nenit 200 paragrafin 4 të Kodit Nr.04/L-123 i Procedurës Penal, e cila përcakton se cilat janë organet përgjegjëse për vizita dhe të drejtat për të komunikuar për të paraburgosurit.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi nr. Protokollit 3512 i datës 20.10.2021 i zëvendës Drejtoreshës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, është nxjerrë në pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjin Nr.06/L-1144 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se:” **I. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje...**”, sepse për shqyrtimin e masës disiplinore “Vërejtje”, në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij ligji, ka kompetencë mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit gjegjësisht Mbikëqyrësja e Lartë e Shërbimit Korrektues në Prishtinë, duke u lidhur me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 2 të Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se: “**1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit**”, “**2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.3 të Ligjit**”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se zëvendës Drejtoresha e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. Protokollit 3512 të datës 20.10.2021 ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjin Nr.06/L-144 për Zyrtar Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores (QRK)Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.943/2021,

Zyle Milaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Zëvendës Drejtoreshës së Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.